



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPLJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Priljeno:	08.10.2025	
Njësia Jednica	Namri Broj	Shtojca Dodatak
05-453/01-57169		



KOMUNA E LIPLJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L- 040- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 të datës 4 qershor 2008, Rregullores MF - NR – 04/2017 mbi Kriteret, Standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, Drejtoresha e DKRS merr këtë :

VENDIM PËR SHPALLJE TË THIRRJES PUBLIKE PËR OJQ (Klubet Sportive Paralimpik)

I

Për shpalljen e Thirrjes Publike për mbështetje financiare publike për projekte/programme të Organizatave Joqeveritare në fushën e Sportit.

II

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF - NR – 04/2017 Mbi Kriteret, Standartet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve Klubeve dhe Shoqatave sportive do të ofrohet nga Buxheti i Komunës (DKRS) kodi 85003 Subvencion në kuadër të programit për Kulturë, Rini dhe Sport

III

1. Mjetet e përmendura në nenin II do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, (Klubeve dhe Shoqatave sportive) sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

IV

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshinë:
 - 1.1 Teksti i thirrjes publike ;
 - 1.2. Udhëzimet për aplikantët ;
 - 1.3. Formularët e aplikimit ;
 - 1.4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve ;
 - 1.5. Format për raportimin e zbatimit të projektit ;

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:

- 2.1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit ;
- 2.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit ;
- 2.3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta ;
- 2.4. Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme) ;
- 2.5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike ;
- 2.6. Deklarata për Aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet).

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit ;
2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin ;
3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit ;

V

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare (web faqe).

VI

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranura që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VII

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport .

VIII

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Lipjan 08.10.2025



Anila Reçica Llugiqi

Drejtoreshë e DKRS-së